

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2435/15 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

V E N D I M

Nr. 127, datë 24.10.2025

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM
EKONOMIK", TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE - JURIDIKE,
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimin të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; në Urdhërin e MAS Nr. 413, datë 14.07.2022 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga Bachelor në "Politikë Ekonomike", në Bachelor në "Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik", me diplomë të dyfishtë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës me Universitetin "La Sapienza" Romë"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; si dhe referuar relacionit Nr. 1161/3 prot., datë 21.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 24.10.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik", të Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore i Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

